



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.50/2018

Prishtinë, më 17 prill 2019

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Saranda Bogujevci, Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, Shemsi Sylja dhe Fisnik Ismaili.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Aida Sekiraqa KDI, Drita Vitia-Radio Kosova, Arta sopi-Kallxo. kom, Ariana Matoshi-RTK, Mirjeta Duraku-Kosova Press, Nora Kelmendi-Ekonomia Online, Fehmi Pajaziti-FSPO, Emsal Limani-MZHE, Hilmi Jasahri-Avokat i Popullit, Mehdi Geci-IAP, Nasuf Hasani-Avokat, Hysni Gashi-FSPE, Hajdar Ibrahimimi-FSPE, Emine Jakupi-praktikante dhe Zana Ulaj-praktikante e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Diskutim në Komision lidhur me peticionin e Kryesisë së Federatës së Sindikatave të Pavarura Elektro-Kosova (FSPE) për moszbatimin e vendimeve të Gjykatës për kthimin e punëtorëve në punë.
Të ftuar: z. Valdrin Lluka – ministër i Zhvillimit Ekonomik, z. Hilmi Jashari – Avokat i Popullit, përfaqësuesit e KEDS-it, dhe përfaqësuesit e FSPE-së.
2. Të ndryshme.

1. Diskutim në Komision lidhur me peticionin e Kryesisë së Federatës së Sindikatave të Pavarura Elektro-Kosova (FSPE) për moszbatimin e vendimeve të Gjykatës për kthimin e punëtorëve në punë

Kryetarja: Sot do të diskutojmë për peticionin e kryesisë të sindikatës së pavarur të Elektro-Kosovës për mos zbatimin e vendimit të gjykatës për kthimin e punëtorëve në punë, pa prezencën e përfaqësuesve të KEDS-it, të cilët kanë qenë të ftuar, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje për mos praninë e tyre në këtë mbledhje.

Hysni Gashi: Ne kemi qenë të shtyrë të marrim hapin për një konsultim për shkak të mos zbatimit të vendimit të gjykatës dhe mos inspektimit të punës për kthimin e punëtorëve në punë, që nga momenti i largimit të këtyre 100 punëtorëve. Ne jemi drejtuar tek inspeksioni i punës, dhe inspektorati i punës ka konstatuar që largimi i punëtorëve është i kundërligjshëm dhe kanë kërkuar që të rishikohet vendimi i menaxhmentit, të cilën gjë nuk e kanë bërë.

Të gjitha vendimet e gjykatave, si Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, janë marrë në favor të punëtorëve dhe në fund Gjykata Komunale ka dhënë urdhër që të merret vendimi i përmbarimit dhe as kjo nuk është zbatuar.

Duke parë mos zbatimin e këtyre vendimeve ne ju kemi drejtuar komisionit tuaj se çka të bëjmë më tutje. Menaxhmenti i KEDS-it e konteston në tërësi ligjshmërinë e gjitha vendimeve dhe kërkon në Gjykatën Kushtetuese ligjshmëri, më 14 dhjetor KEDS-i ka kërkuar një shqyrtim të ligjshmërisë të këtyre vendimeve dhe nuk i kthen punëtorët në punë dhe nga 14 dhjetori i vitit 2018 nuk kemi më asnjë informatë. Këta punëtorë po mbahen padrejtësisht jashtë punës dhe duhet të kthehen në punë.

Nasuf Hasani tha se sa i përket kontestimit të vendimit të inspektoratit të punës këtu kemi të bëjmë me procedurë përmbarimore, vendimet e inspektoratit të punës si organ kompetent, janë të ekzekutuara menjëherë pas shkallës së dytë, kemi një rast ku KEDS-i nuk e ka respektuar vendimin e gjykatës edhe pse njëherë është gjobitur KEDS-i me shumë prej 4000 euro, ndërsa tani është gjobitur me 10.000 euro, dhe përkundër këtyre gjobave KEDS-i nuk ka vepruar.

Nga fundi i vitit të kaluar e kam njoftuar gjykatën me parashtrësë, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje për shkak se te procedura përmbarimore jepet afat sa i përket vendimeve për t'u zbatuar, mirëpo edhe përkundër kësaj gjykata nuk ka vepruar edhe në shqiptimin e një gjobe tjetër deri në momentin e zbatimit të vendimit gjykata duhet të veprojë në drejtim të shqiptimit të gjobave.

Emsal Limani tha se ne, si Ministri e Zhvillimit Ekonomik, para dy muajve kemi mbajtur takim me komitetin qeveritar të privatizimit, të cilëve edhe ju raportojmë, dhe njëra ndër çështjet kryesore që është diskutuar ka qenë çështja e 127 punëtorëve të cilët edhe kanë protestuar.

Si njësi, me qëllim të raportimit të ministri i zhvillimit ekonomik, kemi dërguar pyetjet në KEDS, dhe sipas KEDS-it largimi i këtyre punëtorëve është bërë për shkak të mbylljes së departamentit për projekte speciale, që do të thotë se KEDS-i i ka parë këta punëtorë si të pa nevojshëm për shkak të procedurave të reja dhe futjes së teknologjive të reja, dhe sipas KEDS-it kjo çështje nuk është e përfunduar, por është në Gjykatën Kushtetuese në pritje të seancës dëgjimore.

KEDS-i, ka shpjeguar që për këta punëtorë me rastin e largimit ka afuar një pako financiare dy paga bruto dhe këshillimin e karrierës prej 12 muaj. Këto janë të gjitha përgjigjet zyrtare nga

ana e KEDS-it dhe këta punëtorë nuk e kanë pranuar këtë vendim dhe janë ankuar në inspektoratin e punës, dhe inspektorati ka marrë një vendim për kthimin e këtyre punonjësve, por sipas KEDS-it është gjykata që vendosë në marrëdhëniet punëtorë dhe punëdhënës dhe si e tillë kjo çështje nuk është e përfunduar.

Ne, si ministri, e dimë që Qeveria e Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen e implementimit dhe me rastin e privatizimit më 8 maj 2013 ka garantuar për këta punëtorë vetëm për 3 vite vende të punës dhe kjo garanci ka skaduar më 8 maj 2016, besoj që pas skadimit të garancisë edhe kompania ka të drejtë të bëjë ndryshime, por çdo herë është e obliguar t'i respektojë ligjet e Kosovës.

Kryetarja, pyeti përfaqësuesen e ministrisë, se a keni bërë diçka për t'i mbështetur punëtorët.

Emsal Limani tha se ne nuk kemi kompetenca si njësi për arsye se ka skaduar garancia në lidhje me punëtorët, Qeveria e Kosovës ka garantuar vetëm për 3 vjet dhe pas skadimit të kësaj garancie ne nuk kemi kompetenca.

Nasuf Hasani, a e keni kërkuar vendimin e inspektoratit të punës, a e keni pas në dorë atë vendim?

Emsa Limani: Jo, ne, si njësi, nuk e kemi pasur sepse ne jemi sekretariat teknik.

Nasip Hasani: Atëherë nuk pajtohem me këtë konstatim sepse në vendimin e inspektoratit të punës potencohet me saktësi dhe korrektësi vendimet e jashtë ligjshme sa i përket këtyre punëtorëve, kështu që është dashtë që si ministri ta keni edhe ju atë vendim, unë kam punuar aty vetë dhe ato departamente nuk kanë ekzistuar, aty janë bërë departamente fiktive, vetëm sa me arsyetuar vendimin.

Sami Pajaziti: Interpretimi nga ana e ministrisë është i kundërt, nuk atakon me drejtësinë sepse vendimi për ruajtjen e vendit të punës është në mënyrë decisive për punëtorët të cilët kanë kontrata me afat të caktuar, kurse për punëtorët të cilët janë me kontrata të përhershme ose me afat të pa caktuar i vazhdohet kontrata me të njëjtën mënyrë.

Hilmi Jashari: Niveli i kontrollit parlamentar që ushtrohet mbi bazën nga Kuvendi i Kosovës, i referohet qeverisë dhe zyrtarëve qeveritarë, mirëpo jo zyrtarëve dhe shërbyesve civilë të cilët eventualisht delegohen nga ministri dhe pa asnjë autorizim, sepse sot do të ishim në rregull nëse ministri do të ishte vetë këtu, kjo është pa përgjegjshmëri e madhe e ministrave ndaj parlamentit sepse e pamundëson parlamentin për të marrë vendime, gjithashtu kjo vlen edhe për përfaqësuesit e KEDS-it.

Ky debat që jemi duke e bërë është i panevojshëm sepse ekzistojnë vendimet e plotfuqishme gjyqësore në dy shkallë të nivelit të parë dhe të dytë, Gjykata e Apelit dhe përmbarimor. KEDS-i sigurisht që ka të drejtë të shfrytëzojë të gjitha mundësitë juridike duke provuar atë me konfliktin administrativ apo eventualisht atë me gjykatën kushtetuese, mirëpo të gjitha këto nuk e ndalojnë përmbarimin e një aktgjykimi të plotfuqishëm në procedurë të rregullt në gjykatë.

Këtu është një situatë ku kemi të bëjmë me të drejtat e punëtorëve, ku çdo sistem juridik ju jep përparësi të drejtave të punëtorëve krahasuar me çështjet tjera sepse konsiderohet çështje shumë e ndjeshme, është jo e logjikshme edhe nga ana e KEDS-it për ta zvarritur këtë proces por mbi të gjitha është e pa nevojshme të diskutohet çfarë do aspekti tjetër sepse kemi të bëjmë

me vendime të plotë fuqishme të gjykatës dhe do të duhej të ndodhte përmbartimi në mënyrë të dhunshme. Prandaj, thirrja që mund të bëhet sot është pikërisht kjo, të respektohet vendimi sepse aktvendimi i gjykatës është i barasvlershëm me fuçinë e ligjit, prandaj çdo kush që shkelë mbi këto parime, vendimi i gjykatës ka fuçi të ligjit, ligji është mbi kontratën dhe ka fuçi më të madhe juridike kështu që është e pa kontestueshme. Këtu kemi të bëjmë me situata të drejtave individuale që është kërkuar mbrojtje prej institucioneve që janë të thirrura të vendosin mbi bazën e ligjit këta e kanë vendosur edhe inspektorati edhe gjykata.

Teuta Haxhiu: Konsideroj që në momentin që flasim për institucionet të cilat kanë vendime që shpesh ndodh që vendimet e gjykatave të stërzgaten deri sa të vijnë si vendime, po flasim për vendimet që janë sjellë për vendimet e inspektoratit të punës dhe nuk e di se çka duhet tjetër të presim. Ju si përfaqësuese e ministrisë është mirë që të keni shumë fakte për ta kundërshtuar, këtu do të duhej më shumë ministria të bënte për këta punëtorë, por po shoh që nuk keni punuar fare në këtë drejtim, dhe konsideroj që kjo që u tha më herët që deri në 3 vite ju garantohet këtyre punëtorëve, mirëpo sa bisedova me përfaqësuesit që i kemi këtu na thanë të kundërtën, sot në mungesë të përfaqësuesve të KEDS-it unë konsideroj që asnjëri nga ne nuk e kemi të drejtën të jemi avokat të tyre.

Saranda Bogujevci: Zonja Limani jeni duke u bazuar në raportet zyrtare të KEDS-it, por duhet të keni kujdes në kuptimin e arsytimit për shkak që i keni edhe ligjet që funksiononi si ministri që shkojnë përtej kontratës, dhe nuk mjafton të thuhet vetëm që keni të dhëna nga KEDS-i kur ekzistojnë vendime gjyqësore. Ekzistojnë raporte të ndryshme prej Avokatit të Popullit, ju duhet të merrni të dhënat nga të gjitha anët jo të bazoheni vetëm në një kontratë nga KEDS-i. Kërkojë që të merren prej Avokatit të Popullit propozime konkrete se çka mund të bëjmë ne, si komision, në këtë drejtim, nuk mjafton vetëm të bisedohet për këtë çështje.

Mexhide Mjaku-Topalli: Ne kemi parë që ky peticion është i bazuar sepse ka dy vendime një të Inspektoratit të Punës dhe një të Gjykatës Komunale të Prishtinës, nuk ka kuptim të diskutohet deri sa KEDS-in nuk e kemi këtu sepse nuk mund ta marrim një vendim deri sa nuk janë prezent, përndryshe ne mund ta shkruajmë një shkresë drejtuar KEDS-it që ta marrë një vendim shumë shpejtë brenda 10 dite duke u bazuar në atë që vendimi i Qeverisë ku avokati e sqaroi që nuk është një vendim i dedikuar për punëtorët të cilët janë me kontratë të përhershme. Ju, si ministri, çfarë keni ndërmarrë pas asaj a e keni vërejtur këtë dukuri që nuk është për të gjithë punëtorët, por është vetëm për disa punëtorë që të merret ky vendim që të largohen nga vendi i punës.

Kryetarja: Ne, si komision, do të vendosim se çfarë mund të bëjmë, por ju në ministri tani si mund t'i ndihmoni punëtorët, a mund t'i bëni presion KEDS-it, t'i pranojë prapë punëtorët në punë. Kush është përgjegjës direkt në ministri për këtë punë.

Emsal Limani: Ne, si ministri, apo njësi e post privatizimit kemi bërë mbikëqyrjen në lidhje me çështjen e punëtorëve, dhe deri në maj të vitit 2016, pastaj ka pas ndryshime dhe largime nga puna, unë mendoj që kjo duhet të zgjidhet nëpërmjet gjykatës. Si ministri kemi pasur mundësi të ndërhyjmë deri në momentin kur ka përfunduar marrëveshja, tani kjo çështje ka kaluar në gjykatë është marrë vendimi dhe duhet të respektohet, nëse mund të ndihmojmë diçka jemi të gatshëm, por për garancinë ka skaduar tani, çështja është mes punëtorëve dhe gjykatës. Pritet të mbahet prapë takimi i ministrave dhe të ndërmerren hapa të mëtutjeshëm.

Hysni Gashi: Kur kemi pasur në maj 2016 mos vazhdim të kontratës 74 punëtorëve të larguar nga puna ne, si sindikatë, nuk kemi marrë hapa, jemi pajtuar me faktin, por tani kur i kanë larguar punëtorët që është dashtë të trajtohen sipas ligjit të punës, ne po reagojmë. Ne, si sindikatë, do të japim kontributin për zgjidhjen e kësaj çështje, ju si Ministri e Zhvillimit Ekonomik shumë mirë keni qenë të njoftuar për gjitha veprimet e KEDS-it që i ka marrë kundër punëtorëve.

Nasuf Hasani: kam kopjen e procesverbalit të seancës së mbajtur në gjykatë më 21 dhjetor 2018, ku ndër të tjerash përfaqësuesi i KEDS-it thotë, se nuk kanë ditur se si të zbatohet dokumenti i inspektoratit të punës. Ndërsa vendimet e inspektoratit të punës shumë qartë thotë se te ligji i punës në momentin kur është shkëputur marrëdhënia e punës ndaj punonjësve ka qenë në fuqi marrëveshja e përgjithshme kolektive dhe ligji i punës, aty thuhet se kinse ato departamente janë krijuar përkundrazi KEDS-i në vazhdimësi ka marrë punonjës të rinj.

Kryetarja tha se prej sot ne, si komision, do të marrim një vendim me Avokatin e Popullit dhe do të mundohemi t'i ndihmojmë aq sa ne kemi kompetencë.

Hilmi Jashari: Ministri po të ishte korrekt do të duhej që të përcillte autorizimin me shkrim këtij komisioni dhe personit që e përfaqëson atë në mënyrë që të përfaqësohet denjësisht që të merren vendime sot, por nuk mund të marrim qëndrime, do të ishte e rrugës që komisioni të dërgonte një letër ministrit dhe t'i jepet një afat shkurtër 4 deri 5 ditë në mënyrë që të shfaqë qëndrimin e tij ai në këtë çështje, sepse në fund të fundit Ministria e Zhvillimit Ekonomik është përgjegjëse për mbikëqyrjen e KEDS-it.

Kryetarja, konstatoi se komisioni vendosi t'i drejtohet Ministrit të Zhvillimit Ekonomik me një shkresë dhe t'i jepet një afat 4 deri 5 ditë, pastaj ne mund të marrim një vendim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje